



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës

Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Në mbështetje të nenit 28 paragrafi 1.7, Neni 29 i Ligjit Nr.03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Plotësim ndryshimin e ligjit nr.03/l-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr.04/L-226, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës, lidhur me Kërkesën me nr. Prot. 199/19-01/H. e dt.11.07.2019 nga Operatori Ekonomik kundër Agjensionit për Zhvillimin e Bujqësisë për Çmimoren e Granteve, në mbledhjen e mbajtur me datën 21.11.2019 jep këtë:

REKOMANDIM

- I. Autoriteti Kosovar i Konkurrencës, angazhohet për të gjitha format e parandalimit, kufizimit ose keqpërdorimit të konkurrencës (Abuzimit me Pozitën Dominuese, Marrëveshjeve të Ndaluar, Praktikave të Bashkërenduara dhe Realizimit të Përqendrimeve të Paligjshme) nga ndërmarrjet private apo publike, por edhe nga kufizimet e shkaktuara nga **administrata shtetërore dhe entet rregullatore** në territorin e Republikës së Kosovës ose jashtë saj, nëse këto veprime kanë efekte në Kosovë.
- II. Parimi themelor i ligjit dhe politikës së konkurrencës është të sigurojë qasje në treg të lirë për çdo ndermarrje e cila i plotëson kushtet për të konkuruar në atë treg në interes të përdoruesve të produkteve/shërbimeve dhe të mund të konkurrojnë me çmim dhe cilësi.
- III. Ministria e Bujqësisë perkatësisht Agjensioni për Zhvillimin e Bujqësisë gjatë përpilimit të çmimoreve me çmime referente për grante të kujdeset për një trajtim të barabartë për të gjithë operatorët në këtë treg duke pas parasysh politikën e konkurrencës.
- IV. Komisioni për përpilimin e çmimoreve, duhet të marrë ofertat e të gjithë operatorëve të cilët operojnë në këtë treg duke ju krijuar mundësi të konkurrojnë me çmime dhe cilësi të produkteve.
- V. Sipas nevojës nëse ka ndryshime në treg të shiqohet mundësia që kjo çmimore të rishikohet më shumë se një herë gjatë vitit varësisht nga dinamika e çmimeve.

Autoriteti lëshon këtë rekomandim nga pikëpamjet e Ligjit dhe politikave të konkurrencës.

AUTORITETIT KOSOVAR I KONKURENCËS

KOMISIONI

Valon Prestreshi

Kryetar



Ahmet Krasniqi
Zëvendëskryetar



Fatimë Haziri
Anëtare



Muhamed Krasniqi
Anëtar



Shaqir Morina
Anëtar

Me këtë Rekomandim njoftohen

- Arkiva
- Agjencioni për Zhvillim të Bujqësisë (AZHB)
- Palës